



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/29

Datë: 15.05.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 15 maj 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-026 për Markat Tregtare.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Projektligjin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/29

Datë: 15.05.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësive administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011 në mbledhjen e mbajtur më 15 maj 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Koncept-dokumenti për rregullimin e të Drejtës Ndërkombëtare Private.
2. Obligohet Ministria e Drejtësisë dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/29

Datë: 15.05.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 29 të Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, ndryshuar dhe plotësuar me Ligjet nr.03/L-221, 04/L-165, nr. 04/L-194, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011 në mbledhjen e mbajtur më 15 maj 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Ndahen mjete financiare në vlerë prej 303,000.78 (treqind e tremijë euro e shtatëdhjetë e tetë cent) nga nën-programi Shpenzimet e paparashikuara me kod 131 për ekzekutimin e vendimit P. nr. 690/2014 të datës 07.04. 2015.
2. Mjetet nga pika 1. e këtij vendimi transferohen në Ministrinë e Financave-Thesar nën-programi me kod 112.
3. Obligohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/29

Datë: 15.05.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 4 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 15 maj 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Nisma e Ministrisë së Financave për negocimin e Marrëveshjes Ndërkombëtare për shqyrtimin e kërkesës për Bashkëpunim Financiar me Qeverinë Federale të Republikës së Gjermanisë për vitin 2014.
2. Përgjatë negocimit të kësaj marrëveshje obligohet Ministria e Financave të procedoj konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe dispozitave tjera në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/29

Datë: 15.05.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011 në mbledhjen e mbajtur më 15 maj 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Themelohet Komisioni Ndërministror për Kthim në këtë përbërje:

| | |
|--|------------|
| 1.1. Ministri i Ministrisë për Komunitete dhe Kthim, | Kryesues; |
| 1.2. Zëvendëskryeministri, Zyra e Kryeministrit, | anëtar, |
| 1.3. Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme, | anëtar; |
| 1.4. Ministri i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, | anëtar; |
| 1.5. Ministri i Ministrisë së Drejtësisë, | anëtar; |
| 1.6. Ministri i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, | anëtar; |
| 1.7. Ministri i Ministrisë së Financave, | anëtar; |
| 1.8. Ministri i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, | anëtar dhe |
| 1.9. Ministri i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, | anëtar. |

2. Obligohet Komisioni Ndërministror për Kthim në bazë të Strategjisë për Komunitete dhe Kthim 2014-2018 të bëjë zbatimin e këtij vendimi.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/29

Datë: 15.05.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjesisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011 në mbledhjen e mbajtur më 15 maj 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Me këtë vendim përcaktohen rregullat dhe procedurat për dëshmimin e përvojës së punës për të punësuarit në sektorin publik të cilët realizojnë pagë nga buxheti i Kosovës me qëllim të pagesës së shtesës mbi përvojën e punës si dhe realizimit të të drejtave tjera që lidhen me pushimin vjetor.
2. Njohja e përvojës së punës pas Qershorit 1999 dëshmohet përmes njërit nga këto dëshmi:
 - 2.1. Dëshmisë mbi përvojën e punës të lëshuar nga njësia kompetente për menaxhimin e personelit në Institucionet e Republikës së Kosovës ose nga UNMIK-u.
 - 2.2. Dëshmisë mbi përvojën e punës të lëshuar nga ndërmarrjet publike ose nga ndërmarrjet shoqërore të cilat kanë qenë ose janë nën administrimin e AKP-së ,
 - 2.3. Dëshmisë mbi përvojën e punës të lëshuar nga ndërmarrjet private dhe punëdhënësit tjerë duke bashkëngjitur edhe dëshminë për kryerjen e obligimeve mbi të ardhurat personale për punëtorin ose dëshminë mbi pagesën e kontributeve pensionale pranë organit kompetent.
 - 2.4. Dëshmisë së përkthyer mbi përvojën e punës të lëshuar nga organi kompetent i një shteti të huaj në të cilin punëtori ka punuar.
 - 2.5. Dëshmisë mbi përvojën e punës të lëshuar Organizatat Qeveritare dhe Joqeveritare vendore dhe ndërkombëtare të shoqëruara me dëshminë për kryerjen e obligimeve mbi të ardhurat personale ose dëshminë mbi pagesën e kontributeve pensionale pranë organit kompetent.
 - 2.6. Çdo dëshmie tjetër të vërtetuar në procedurë gjyqësore përmes aktgjykimit të plotfuqishëm.
 - 2.7. Si dëshmi tjetër plotësuese mund të konsiderohet edhe lista e pagave.

3. Njohja e përvojës së punës para Qershorit 1999 dëshmohet përmes njërës nga këto dëshmi:
 - 3.1. Dëshmime të ofruara nga Departamenti i Pensioneve nga Ministria për Punë dhe Mirëqenie Sociale.
 - 3.2. Dëshmi tjera të vlefshme për njohjen e përvojës së punës janë edhe:
 - 3.2.1. Librezën e punës me numrin amëz të të siguruarit (të kompletuar),
 - 3.2.2. Dëshmi se i ka paguar kontributet vet dhe punëdhënësi ku ka punuar, dëshmi të cilat detyrimisht do të verifikohen nga zyrtarët e Departamentit të Pensioneve pranë MPMS, sipas dispozitave të aplikueshme nga sigurimi pensional dhe invalidor i Kosovës deri në vitin 1989;
 - 3.3. Dëshmi të vlefshme plotësuese mund të jenë:
 - 3.3.1. Regjistri i rrogave,
 - 3.3.2. Kartela e rrogave,
 - 3.3.3. Vendimi për themelimin e marrëdhënies së punës,
 - 3.3.4. Formulari për paraqitje në sigurim dhe ndërprerje të sigurimit (M-1,M-2),
 - 3.3.5. Vendimi për rrogën, rritje dhe harmonizim,
 - 3.3.6. Vendimi për pushimin vjetor,
 - 3.3.7. Vendimi për ndërprerjen e marrëdhënies së punës,
 - 3.3.8. Vendimi në origjinal të ish BVI-së së punësimit e në të cilin janë të shënuara të dhënat për stazhin e punës,
 - 3.3.9. Vërtetimi nga AKP-ja (Agjencinë Kosovare për Privatizim), për stazhin e punës,
 - 3.3.10. Zejtarët privat duhet të sjellin dëshmi-certifikatë për pagesën e kontributeve të lëshuara nga organi kompetent komunal.
 - 3.3.11. Vërtetimin e lëshuar në origjinal nga kompania private me vule dhe nënshkrim, të shoqëruar me një deklaratë nën betim.
4. Dëshmimi i përvojës së punës për kategoritë e tjera që me ligj i njihet kjo e drejtë e nuk janë pjesë e dëshmime të cekura në pikën 2 dhe 3 bëhet përmes ofrimit të dëshmime nga institucioni përkatës me të cilave vërtetohet përvoja e punës.
5. Përvojë e punës nuk konsiderohet, përvoja e kaluar në punë praktike si dhe përvoja e të zgjedhurve dhe të emëruarve të cilët ushtrojnë funksionin në orar jo të plotë të punës përmes pjesëmarrjes në mbledhje që paguhen me honorar.
6. Njësia përgjegjëse për burime njerëzore në çdo institucion, në pajtim me këtë vendim, vendos për njohjen e përvojës së punës së një nëpunësi i cili realizon pagë nga buxheti i Kosovës. Vendimi i përvojës së punës bëhet pjesë e dosjes së personelit për secilin nëpunës dhe ruhet sipas legjislacionit në fuqi.
7. Njësia përgjegjëse për burime njerëzore pas njohjes së përvojës së punës, harton listën e cila përmban: emrin e institucionit, emrin dhe mbiemrin e nëpunësit, nr. personal, vitet e përvojës së punës. Lista nënshkruhet nga menaxheri i personelit dhe nga udhëheqësi më i lartë administrativ i institucionit e cila me pastaj dërgohet në Ministrinë përgjegjëse për Administratë Publike.

8. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen të gjitha organizatat buxhetore, Ministria e Administratës Publike dhe Ministria e Financave.

9. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/29

Datë: 15.05.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011 në mbledhjen e mbajtur më 15 maj 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Komunës së Gjakovës për ndarjen e mjeteve financiare në vlerë prej 500,000.00 euro nga Fondi i shpronësimit i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, për nevoja të kompensimit të shpronësimit të ndërtimit të rreth rrotullimit në hyrje të rrugës rajonale Prizren-Gjakovë, në Komunën e Gjakovës.
2. Obligohen Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Ministria e Financave dhe Komuna e Gjakovës për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 08/29

Datë: 15.05.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësive administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011 në mbledhjen e mbajtur më 15 maj 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Rregullorja për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar dhe Menaxhimin e Programit të Riintegritimit.
2. Obligohet Ministria e Punëve të Brendshme dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e rregullores nga pika 1. e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë